



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 10/8, DATË 04 / 02 / 2021

**PËR MIRATIMIN E STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK
PROCEDURË E VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT ME
POTENCIAL STRATEGJIK “COAST TO COAST”**

Në mbështetje të Nenit 9, 17, 18 dhe 22 të ligjit Nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Vlera e investimit të projektit “Coast to Coast plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për investimet strategjike dhe parashikohet të jetë 56,910,000 (pesëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e dhjetë mijë) Euro.
- Projekti plotëson kriteret e punësimit të kërkuara nga legjislacioni për investimet strategjike. Përgjatë fazës së realizimit të investimit dhe operimit, numri i të punësuarve parashikohet të jetë 150 (njëqind e pesëdhjetë) persona.

- Projekti do të realizohet nga subjektet "Gjiguria" sh.p.k. me NIPT J62903456H dhe "Coast to Coast" sh.p.k. me NIPT K97117201D.
- Projekti parashikon ndërtimin e një investimi kompleks të përbërë nga 3 hotele dhe vila rezidenciale me sipërfaqe truall 20.9 ha në zonën kadastrale 1739, në fshatin Gajtanitika dhe Perivolo, Himarë.
- Subjekti është pajisur me Leje Zhvillimore, lëshuar sipas Vendimit Nr.25, datë 03.10.2018, për “Lejen e zhvillimit për objektin Resorti Turistik “Coast to Coast”, Gjilekë, Bashkia Himarë” miratuar nga KKT .

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Miratimin e Statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” për projektin e investimit me potencial strategjik “Coast to Coast”.
2. Projekti “Coast to Coast” do të realizohet nga subjektet "Gjiguria" sh.p.k. me NIPT J62903456H dhe "Coast to Coast" sh.p.k. me NIPT K97117201D.
3. Projekti strategjik parashikon realizimin e investimit në sektorin strategjik të Turizmit.
4. Projekti parashikon ndërtimin e një investimi kompleks të përbërë nga 3 hotele, vila rezidenciale, rinovimi i 40 (dyzet) shtëpive tradicionale dhe 1 (një) fermë me prodhimet bujqësore, në një sipërfaqe totale prej 20.9 ha, të ndodhur në zonën kadastrale 1739, në fshatin Gajtanitika dhe Perivolo, Himarë.
5. Statusi “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë” i jepet projektit të investimit “Coast to Coast”, për një periudhë 4 (katër) vjeçare, përveç afatit të lejimit të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit si dhe afateve të lejimit të përdorimit të pasurive të paluajtshme shtetërore, të cilat vendosen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike, përkatësisht neni 22, neni 24, neni 27 dhe neni 29 i Ligj Nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, masat mbështetëse që i jepen projektit janë si më poshtë:

- a) Miratohet masa mbështetëse e kryerjes së procedurave me prioritet dhe brenda afateve të përshpejtuara, në përputhje me legjislacionin për investimet strategjike;
- b) Miratohet masa mbështetëse e asistencës në lidhje me dhënien e lejeve, licencave dhe autorizimeve të nevojshme për realizimin e projektit, në përputhje me afatet e parashikuara sipas legjislacionit të investimeve strategjike;
- c) Miratohet në parim masa mbështetëse konsolidim toke, ndryshim destinacioni në përputhje me PPV Bashkia Himarë si dhe vënie në dispozicion të pasurisë së paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar ndodhur ndërmjet pronave private, në ZK 1739 për zhvillimin dhe realizimin e këtij projekti investimi strategjik, pas përfundimit të regjistrimit fillestar të zonës.

Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 55/2015, i ndryshuar, miratimi përfundimtar i masës mbështetëse të mësipërme do të rregullohet me Vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi, lidhur me mënyrën dhe afatet e vënies në dispozicion të këtyre pasurive të paluajtshme në pronësi të shtetit shqiptar, me qëllim realizimin e strukturës akomoduese turistike të parashikuar në këtë projekti investimi, vetëm pasi të jenë kryer të gjitha verifikimet e nevojshme, për sa i përket saktësisht të vendndodhjes (parcelat e detajuara), sipërfaqes, statusit të tyre juridik dhe për aq kohë sa nuk ekzistojnë mosmarrëveshje administrative dhe/ose gjyqësore me shtetin në pasurinë objekt të investimit strategjik.

7. Në zbatim të nenit 29 të Ligj Nr.55/2015, i ndryshuar, miratohet në parim masa mbështetëse e lejimit të përdorimit të brigjeve të detit si dhe zonën përkatëse të plazhit përballë kompleksit, por në asnjë rast për një afat më të gjatë se 30 (tridhjetë) vjet, me koordinata sipas Sistemit Shtetëror Shqiptar.

- Miratimi përfundimtar, si dhe tarifa e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse së plazhit në funksion të realizimit të projektit investues strategjik do të parashikohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
8. Mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e masave mbështetëse përcaktohen edhe në planin e veprimit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 9. Në rast se përgjatë zhvillimit dhe zbatimit të projektit investues strategjik “Coast to Coast” konstatohen të dhëna të pavërteta, të rreme apo ndryshime të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për miratimin e statusit strategjik të këtij projekti me procedurën e veçantë, Komiteti i Investimeve Strategjike, ka të drejtë të revokojë vendimin për dhënien e statusit strategjik.
 10. Ky vendim i njoftohet investitorit si dhe publikohet në regjistrin e investimeve strategjike.
 11. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për propozim në Këshillin e Ministrave të vendimit të dhënies së të drejtës subjekteve "Gjiguria" sh.p.k me NIPT J62903456H dhe "Coast to Coast" sh.p.k. me NIPT K97117201D për përdorimin e brigjeve të detit dhe zonës përkatëse të plazhit në funksion të projektit të investimit strategjik “Coast to Coast”.
 12. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për të propozuar në Këshillin e Ministrave vendimin për vënie në dispozicion të pasurisë së paluajtshme shtetërore për realizimin e projektit të investimit strategjik "Coast to Coast" në zbatim të legjislacionit në fuqi, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligj Nr. 55/2015, i ndryshuar.
 13. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për paraqitjen dhe përditësimin e të gjitha ndryshimeve të nevojshme në regjistrin kadastral lidhur me zonën në zhvillim.
 14. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për monitorim të realizimit të projektit të investimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

PLANI I VEPRIMIT

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK “COAST TO COAST”

1. Përmbajtja e planit të veprimit

Plani i veprimit për realizimin e një projekti strategjik, përcakton:

- Procedurat lehtësuese që do të zbatohen për realizimin e investimit strategjik dhe afatet e përshpejuara brenda të cilave duhet të kryhen;
- Shërbimet ndihmëse që do të ofrohen ndaj projektit strategjik;
- Masat mbështetëse që do të nevojiten për mbështetjen e investimit strategjik;
- Organet përgjegjëse për zbatimin e investimit strategjik;
- Detyrat përkatëse për secilin organ të përfshirë në realizimin e investimit strategjik;
- Programin e punës për realizimin e investimit strategjik të detajuar në faza;

Zbatimi i planit të veprimit

Plani i veprimit ndiqet dhe zbatohet nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e cila koordinon veprimtarinë me organet e tjera shtetërore dhe me investitorin.

Autoritetet publike, të përfshira në mënyrë direkte apo indirekte në realizimin e një investimi strategjik, kanë detyrimin ligjor në lidhje me trajtimin me prioritet të procedurave dhe brenda afateve të përshpejuara. Këto organe kanë detyrimin ligjor që të bashkëpunojnë dhe t'i japin Agjencisë, sqarime, informacione, lejet, licencat, autorizimet, mendimet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me përgatitjen, zbatimin dhe realizimin e një projekti investues strategjik.

2. Informacione të përgjithshme mbi Planin e Veprimit të projektit “Coast to Coast”

Ky plan veprimi për realizimin e Projektit të Investimit “*Coast to Coast*”, projekt me potencial strategjik, përcakton masat, procedurat dhe afatet, në lidhje me shërbimet dhe lehtësimin e procedurave për hartimin dhe zbatimin e projektit investues strategjik, në të cilin përcaktohen angazhime, detyra dhe afate konkrete për institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, për të gjitha fazat e realizimit dhe zbatimit të projektit.

Plani i veprimit, u hartua nga grupi operacional i krijuar pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, bazuar në karakteristikat e projektit të propozuar. Për këtë qëllim, propozuesi i

investimit strategjik, ka listuar dhe treguar qartësisht në momentin e paraqitjes së aplikimit, procedurat, shërbimet, dhe masat mbështetëse konkrete, të cilat kërkon të përfitojë nga shteti shqiptar, për realizimin e investimit.

Plani i veprimit u hartua pasi propozimi i paraqitur mbi investimin strategjik të Projektit “Coast to Coast” është vlerësuar paraprakisht dhe ka një rekomandim pozitiv të Komitetit të Investimeve Strategjike në lidhje me miratimin e tij. Autoriteti përgjegjës për miratimin e planit të veprimit për çdo projekt strategjik të miratuar është Komiteti i Investimeve Strategjike.

3. Hapat procedurale

Propozimi nga investitorët:

Investitorët "Gjiguria" sh.p.k. dhe "Coast to Coast" sh.p.k. kur paraqitën projektin e investimit strategjik tek AIDA, në përputhje me legjislacionin kanë specifikuar edhe listën e procedurave, shërbimeve dhe masat mbështetëse që kërkojnë për realizimin e investimit strategjik.

Masat mbështetëse që kanë një vlerësim pozitiv nga KIS janë si më poshtë vijon:

Masat e kërkuara	Rekomandim	Institucion i përgjegjës	Procedura për masën e kërkuar e detajuar ne faza. Detyrimet sipas institucioneve përgjegjëse	Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesë subjekti	Afati	Kosto
Kërkohet marrja në përdorim afatgjatë i plazhit përpara kompleksit sipas koordinatave të përcaktuara në hartat përkatëse me afat 99 vjeçar.	PO, me kusht verifikimin e koordinatave të sakta sipas gjurmës së projektit nga MTM dhe Bashkia Himarë dhe në asnjë rast për një afat më të gjatë se 30 (tridhjetë) vjet.	MFE MTM BASHKIA HIMARË	MTM dhe Bashkia Himarë duhet të përcaktojnë koordinatat e sakta të zonës së plazhit. Kjo masë miratohet nëpërmjet një VKM i cili propozohet nga MFE	Identifikim të gjendjes kadastrale e juridike të sipërfaqes në fjalë.		

<p>Vënia në dispozicion të investitorit strategjik e të gjithë hapësirave midis pronave të cilat do të rezultojnë pa pronar pas regjistrimit fillestar të territorit ku do të zhvillohet projekti sipas koordinatave të paraqitura</p>	<p>PO me kusht, vetëm pas përfundimit të regjistrimit fillestar dhe saktësimit të vendndodhjes (parcelat e detajuara), sipërfaqes, statusit të tyre juridik dhe për aq kohë sa nuk ekzistojnë mosmarrëveshje administrative dhe/ose gjyqësore me shtetin në pasurinë objekt të investimit strategjik.</p>			<p>Kjo masë parashikohet në Nenin 27 “Përdorimi i pasurive të paluajtshme shtetërore për realizimin e investimeve strategjike” në Ligjin Nr. 55/2015 “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”.</p>		
--	---	--	--	---	--	--

KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA